

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË
“KOLEGJI PROFESIONAL GJERMAN I TEKNOLOGJISË” sh.p.k**

**TITULLI I
THEMELIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**NENI 1
THEMELIMI, EMRI DHE THEMELUESIT**

Sot më datë 29.12.2020 themeluesit krijojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nën emërtimin **“KOLEGJI PROFESIONAL GJERMAN I TEKNOLOGJISË” sh.p.k**, e cila vepron dhe organizohet në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Ortaku i vetëm, themelues i shoqërisë është:

AUTO STAR ALBANIA SH.A, indentifikuar me numër unik NUIS J62023007G, me adresë e Tirane, Kashar KASHAR Lagjja Kashar, autostrada Tirane Durres, km 7, godine 2-kateshe, nr 10, përfaqësuar nga Administatori Z.Arben BRESHANI lindur më 28.12.1960 në Kallarat,Vlore dhe banues në Tiranë në adresën: Rr. Fadil Bodinaku, Nd. 8 H.15 Ap.1 Njesia Administrative Nr.5, 1022 Tirane madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 033495628 dhe Nr. Personal G01228032H ;

**NENI 2
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Objekti i veprimtarisë i shoqërisë **“KOLEGJI PROFESIONAL GJERMAN I TEKNOLOGJISË” sh.p.k** shpk është:

- Ushtrimi i veprimtarisë në fushën e arsimit të lartë privat, kërkimit shkencor, veprimtrive krijuese dhe profesionale duke krijuar për këtë qëllim institucione të arsimit të lartë sipas legjislacionit në fuqi.
- Të ofrojë programe studimi, kurse të formimit profesional të vazhduar trajnime dhe seminare sipas kornizës ligjor në fuqi, të mbështetura në përvojën dhe praktikatat me të mira të vendeve europiane.
- Të marrë pjesë në gara, konkurse ,projekte kombëtare dhe ndërkombëtare në fushat që lidhen me arsimin e lartë dhe atë profesional në veçanti.
- Të kryejë aktivitete botuese, promovuese dhe reklamuese etj.
- Të realizojë shërbime ndaj të tretëve në fushën e programeve të studimit që do të ofrojë, duke respektuar legjislacionin në fuqi.
- Shoqëria do të zhvillojë çdo lloj aktiviteti tjetër ekonomik që nuk bie ndesh me legjislacionin shqipëtar në fuqi.

**NENI 3
KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë **“KOLEGJI PROFESIONAL GJERMAN I TEKNOLOGJISË” sh.p.k**, është e pakufizuar. Ajo mund të pushojë veprimtarinë e saj në çdo moment, sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve/Ortakut të vetëm, sipas modaliteteve ligjor.

NENI 4
SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë “**KOLEGJI PROFESIONAL GJERMANI TEKNOLOGJISË**” sh.p.k, është në adresën: Tiranë Kashar KASHAR Lagjja Kashar, autostrada Tiranë Durrës, km 7, godinë 2-katëshe, nr 10.

NENI 5
DEGËT, ZYRAT E PËRFAQËSIMIT DHE PJESMARRJET

Shoqëria në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi në Shqipëri ose jashtë saj dhe të fillojë dhe/ose të marrë pjesë në aktivitete të tjera të çdo forme.

TITULLI II
KAPITALI, KUOTAT

NENI 6
KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë, i përbërë nga 1 kuotë me vlerë nominale 100 (njëqind Lekë .

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortaku i vetëm i saj **AUTO STAR ALBANIA SH.A**, i cili zotëron 1 kuotë që përfaqëson 100 % të kapitalit të shoqërisë.

NENI 7
ÇERTIFIKATAT E KUOTAVE TË KAPITALIT

Ortaku, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një certifikatë për të gjitha kuotat që zotëron. Ky vërtetim nuk ka natyrën e letrës me vlerë.

NENI 8
KALIMI I KUOTAVE ME KONTRATE

Pjesët/kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme.

Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe i njoftohet selisë së regjistruar të shoqërisë.

NENI 9
ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Ortaku i Vetëm me vendim mund ta zmadhojë kapitalin, duke rritur numrin e kuotave ekzistuese ose duke rritur vlerën nominale të tyre. I njëjti vendim kërkohet edhe kur zmadhimi i kapitalit pritet t’u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.

Ortaku i vetëm i shoqërisë mund të vendosi zvogëlimin e kapitalit themeltar, pa kaluar vlerën minimale të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

TITULLI III ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 10 FUNKSIONET E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm në përputhje me parashikimet e ligjit Nr. 9901, datë datë 14.4.2008 PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE, i ndryshuar.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

TITULLI IV ADMINISTRATORËT

NENI 11 EMËRIMI I ADMINISTRATORIT/EVE

Asambleja e Përgjithshme/ortaku i vetëm emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë për tre vjet.

Administrator i shoqërisë “**KOLEGJI PROFESIONAL GJERMAN I TEKNOLOGJISË**” sh.p.k, do të jetë, **Z.Florenc PULA**, shtetas shqiptare, lindur më 23.10.1979, në Elbasan dhe banues në Durrës në adresën: L 12, Rruga Abaz Celkupa, Durrës me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit Nr. dhe Nr. 031806969 Personal H91023046C; me një kohëzgjatje të ushtrimit të detyrës për tre vjet, me të drejtë ripërtëritje.

NENI 12 KOMPETENCAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATORIT

Veprimtaria tregtare e shoqërisë menaxhohet nga Administratori i cili mund t’i ushtroj të gjitha kompetencat e shoqërisë që nuk i janë rezervuar Asamblesë së Përgjithshme/ortakut të vetëm nga Ligji.

TITULLI V DIVIDENDËT DHE KAPITALIZIMI I FITIMEVE

NENI 13 DIVIDENDËT

Pas përmbushjes së kërkesave të Nenit 77 të Ligjit, shoqëria, me anë të një vendimi të kualifikuar, mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen kuotave, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat në lidhje me të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët përpjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim me shumat e paguara për kuotat gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Por, nëse kuotat emetohen me kushtin se merr dividend duke filluar nga një datë e caktuar, atëherë kuota në fjalë e merr dividendin sipas këtij kushti.

Asnjë dividend dhe asnjë mjet monetar i pagueshëm në lidhje me një kuota nuk mund të fitojë interesa nga shoqëria nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat që u lidhen kuotës.

Nëse një dividend nuk është tërhequr pas dymbëdhjetë vjetëve nga data kur mund të tërhiqet pagesa, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim të kualifikuar, ky dividend mund të anulohet dhe shoqëria nuk është më e detyruar ta paguajë.

TITULLI VI PRISHJA DHE NJOFTIMET

NENI 14 PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme/ Ortakut të vetëm dhe në përputhje me Ligjin, mund t'u shpërndajë ortakëve/ut të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe, për këtë qëllim, mund t'i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpërndarje e tillë.

NENI 15 NJOFTIMET

Njoftimet që u bëhen ortakëve ose që bëjnë personat sipas Statutit duhet të jenë me shkrim ose me letër rekomande me marrje përgjigje në adresat respektive

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË “KOLEGJI PROFESIONAL GJERMAN I TEKNOLOGJISË” SHPK

AUTO STAR ALBANIA SH.A

Përfaqësuar nga Administratori

Z.Arben BRESHANI


